



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics



Statistikat e Transportit dhe Telekomunikimit

Tetor, 2025

Prishtinë, 15.12.2025 Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur publikimin me të dhëna për Transportin dhe Telekomunikimin për muajin Tetor 2025. Ky publikim statistikorë paraqet të dhëna statistikore me bazë mujore për transportin ajrorë, hekurudhorë dhe telekomunikimin.

Qëllimi i publikimit është të paraqesë tendencën e zhvillimit të këtij sektori për ekonominë e vendit. Besojmë se ky publikim do të shërbejë si bazë e dobishme referuese për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave statistikore të ASK-së, dhe do të shërbejë si informacion i dobishëm dhe relevant ekonomik për Kosovën.

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja mund të dërgoni në adresën zyrtare : infoask@rks-gov.net

Ilir T. Berisha	- Drejtor i Departamentit të Statistikave Ekonomike
Bekim Bojku	- Udhëheqës i Divizionit Statistikave Ekonomike
Qendresa Shala Sopaj	- Zyrtare për Statistika të Transportit dhe Telekomunikimit
Shqipe Zubaku	- Zyrtare për Statistika të Ndërmarrjeve

Tetor, 2025

Drejtor Ekzekutiv i ASK-së
z. Avni Kastrati

1. Metodologjia dhe përkufizimet

1.1. Burimet

Statistikat e Transportit dhe Telekomunikimit janë te bazuara në burimet administrative. Burimet e të dhënave janë Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari “ – LIMAC, Hekurudhat e Kosovës TRAINKOS Sh. A, RAILTRANS ShPK ARKEP- Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, ARC - Agjencia për Regjistrim Civil (Departamenti për Regjistrimin e Automjeteve të Kosovës), Ministria e Infrastrukturës (Drejtoria për rrugë).

1.2. Mbulimi

Të dhënat me bazë mujore janë shfrytëzuar për publikim nga viti 2022 deri në Tetor 2025 janë për Transportin Ajror, Hekurudhor dhe Telekomunikimin.

Publikimi i të dhënave

Të dhënat mujore publikohen 45 ditë pas muajit referues dhe janë të dhëna preliminare.

Të dhënat e publikuara të statistikave të Transportit dhe Telekomunikimit janë:

Në baza mujore : Statistikat e Transportit Ajror, Hekurudhor dhe Telekomunikimit

1.3. Përkufizimet

Ton-kilometër (t km) -Njësia e matjes së transportit të mallrave që përfaqëson transportin e një ton të mallrave mbi një distancë prej një kilometri.

Distanca që duhet mbuluar është distanca që aktualisht është udhëtuar në rrjetin e shqyrtuar. Për të shmangur numërimin e dyfishtë, secili vend duhet të llogarisë vetëm t km që kryhet në territorin e saj.

Simbolet

: - Mungojnë të dhënat

0 -Me pak se gjysma e njësisë se përdorur

- - Nuk aplikohet

2. Transporti Ajror

Në muajin Tetor 2025 Numri i fluturimeve të realizuara ishte 1,168, apo 8.7 % më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ndërsa numri i udhëtarëve gjithsej ishte 386,174 apo 8.7 % më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Tab. 1: Numri i fluturimeve dhe udhëtarëve Tetor 2024 – Tetor 2025

Përshkrimi	Tetor 2024	Tetor 2025	Tetor 2025 / Tetor 2024
1.Numri i fluturimeve të realizuara	1 075	1 168	8.7
2.Numri i udhëtarëve në total (a+b)	355 280	386 174	8.7
a.Numri i udhëtarëve ne ardhje	172 345	184 983	7.3
b.Numri i udhëtarëve ne shkuarje	182 935	201 191	10.0

Fig. 1: Numri i fluturimeve Tetor 2024 – Tetor 2025





Fig. 2: Numri i udhëtarëve Tetor 2024 – Tetor 2025


3. Transporti Hekurudhor

Në muajin Tetor 2025 numri i udhëtarëve ishte 9,080 apo 36.4 % më shumë së në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa sasia e mallrave të transportuar në neto ton ishte zero.

Tab. 2: Transporti hekurudhor Tetor 2024 – Tetor 2025

Përshkrimi	Tetor 2024	Tetor 2025	Tetor 2025 / Tetor 2024
Numri i udhëtarëve	6 655	9 080	36.4
Sasia e mallrave të transportuar në neto tonë	0	0	0
Sasia e mallrave të transportuar në neto tonë/km	0	0	0

Fig. 3: Numri i udhëtarëve ne transportin hekurudhor Tetor 2024 – Tetor 2025



4.Telekomunikimi

4.1. Telefonia Fikse

Në muajin Tetor 2025 numri i përdoruesve në rrjetin e telefonisë fikse ishte 67 783 apo - 0.4 % më pak së në periudhën e njëjte të vitit të kaluar ndërsa trafiku i realizuar (në minuta) ishte rreth 1,981.558 apo 0.7% më shumë së në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Tab. 3: Përdoruesit dhe trafiku i realizuar në telefoninë fikse Tetor 2024 – Tetor 2025

Përshkrimi	Tetor 2024	Tetor 2025	%
			Tetor 2025 / Tetor 2024
Numri i përdoruesve te rrjetit telefonik fiks	68 081	67 783	-0.4
Trafiku i realizuar (në minuta)	1 967 578	1 981 558	0.7

Fig. 5: Numri i përdoruesve te rrjetit telefonik fikse Tetor 2024 - Tetor 2025





Fig. 6: Trafiku i realizuar (në minuta) Tetor 2024 - Tetor 2025

4.2. Telefonia Mobile

Në muajin Tetor 2025 numri i përdoruesve me parapagim (Prepaid) ishte 1.68 milion apo 2.74% më shumë se në periudhën e njëjte të vitit të kaluar, ndërsa numri i përdoruesve me kontratë (Postpaid) ishte 314,902 mije apo 0.26% më shumë së në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Tab. 4: Përdoruesit e telefonisë mobile Tetor 2024 - Tetor 2025

Përshkrimi	Tetor 2024	Tetor 2025	%
			Tetor 2025 / Tetor 2024
Përdoruesit me parapagim (Prepaid)	1 643 382	1 688 441	2.74
Përdoruesit me kontratë (Postpaid)	314 071	314 902	0.26

Fig. 7: Përdoruesit me parapagim (Prepaid)





Fig. 8: Përdoruesit me kontratë (Postpaid)

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129
Drejtori Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax:** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>
- © Agjencia e Statistikave të Kosovës
- Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.